



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË BERAT.

Nr. ____ prot

Berat, më 20.05.2019

N J O F T I M

**PËR FILLIMIN E PROCEDURES SË KONKURIMIT PËR EMËRIMIN
NË POZICIONIN E PUNËS KOORDINATOR**

Bazuar në ligjin nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë", si dhe urdhërit nr 27 date 21.02.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm për "Strukturën organike të Prokurorisë Prane Gjykatës së Shkallës se Parë Berat", me qëllimin plotësimin e vendeve vakante që ekzistojne në strukturën e institucionit në pozicionin Koordinator, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat:

N J O F T O N

1. Fillimin e procedurës për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin Koordinator, pranë Prokurorëve në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.

2. Referuar neneve 74, 75 dhe 76 të ligjit nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë", kandidatët e interesuar për konkurim, përveç kushteve të përgjithshme për t'u pranuar në shërbimin civil, duhet të plotesojnë dhe kriteret e nevojshme por dhe jo te nevojshme si me poshte:

Arsimi, trajnimi dhe eksperiencia:

Kriteret e nevojshme

Të jetë shtetas shqiptar.

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar e të folur.

Të jetë fizikisht i aftë për të kryer detyrën.

Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë një hetim penal në proces;

Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e konkurimit.

Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për psikologji, sociologji, ose fusha të tjera të ngjashme.

Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë, ofruesit e shërbimeve, që operojnë në komunitet, viktimat dhe publikun.

Të ketë aftësi për të ndërvepruar në mënyrë efektive dhe me takt me viktimat emocionalisht të shqetësuara.

Të ruajë sekretin hetimor.

Të ruajë konfidencialitetin e informacionit të viktimës.

Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale.

Të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme në lidhje me viktimat e krimit.

Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si: Microsoft Word, Excel, Power Point, etj.

Kritere të preferuara, por jo të nevojshme:

Njohja e shërbimeve që u ofrohen viktimave të krimit nga ofrues të ndryshëm shtetërorë dhe jo qeveritarë.

Njohja e sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore.

3. Kandidatët për pozicionin e lirë të punës "Koordinator" duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Kërkesë me shkrim,
- b. Kopje të dokumentit të identifikimit,
- c. Curriculum Vitae,
- d. Fotokopje e diplomes dhe listes se notave.
- e. Vërtetim për gjëndjen gjyqësore,
- f. Vërtetim nga Gjykata.
- g. Vërtetim nga Prokuroria.
- h. Çdo dokument tjetër (master, specializime, etj nese ka)

4. Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kandidatit, të paraqitet brenda datës 04.06.2019 në Kryesekretarinë e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.

**KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË BERAT.**